

URDHËR
Nr.409, datë 3.7.2009

PËR PAJISJEN ME DOKUMENTE IDENTITETI TË SHTETASVE SHQIPTARË

Në mbështetje të pikës 4 të nenit 102 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe të ligjit nr.9972, datë 28.7.2008 “Për ratifikimin e kontratës koncesionare “Për prodhimin dhe shpërndarjen e kartave të identitetit dhe të pasaportave elektronike” ndërmjet Ministrisë së Brendshme të Republikës së shqipërisë dhe Grupit të Sagem Securite dhe fondit Shqiptaro-Amerikan të Ndërmarrjeve”, si dhe të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.1, datë 7.1.2009 “Për pajisjen, për herë të parë, me letërnjoftim të shtetasve shqiptarë dhe për përcaktimin e afateve e të masave shtrënguese, për ata që nuk aplikojnë brenda këtyre afateve”, të ndryshuar

URDHËROJ:

1. Fillimin e procesit të aplikimit për dokumentet e identitetit, pasaportë elektronike dhe letërnjoftim për të gjithë shtetasit shqiptarë mbi 16 vjeç.
2. Orari i punës, për zyrat e gjendjes civile në bashki/njësi bashkiake/komuna, do të jetë orari zyrtar.
3. Për ndjekjen e këtij urdhri ngarkohen prefektët, njësitë e qeverisjes vendore dhe Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile.
4. Urdhri nr.350, datë 28.5.2009 “Për aplikimin e shtetasve shqiptarë, të cilët disponojnë pasaportë për jashtë shtetit për pajisje me letërnjoftim elektronik” dhe çdo urdhër tjetër që bie në kundërshtim me të, shfuqizohet.

Ky urdhër hyn në fuqi menjëherë.

MINISTRI I BRENDSHËM
Bujar Nishani